



A. Musa Tolaj, Nartel Center, Llam. A, H-1,
Kati 12, nr. 65-1, Prishtinë, Kosovë.
T. +383 38 600 633, +383 38 600 644
E. office@kcsfoundation.org
W. www.kcsfoundation.org

FTESË PËR KUOTIM TË ÇMIMIT

Shërbime të përkthimit

NR. I REFERENCËS: FPK 01/2025

PËRMBAJTJA

<u>FTESE PËR KUOTIM TË ÇMIMIT</u>	3
<u>Përshkrimi i Fushëveprimit</u>	4
<u>Vlerësimi i Ofertave - Kriteret e dhënies së kontratës</u>	6
<u>Shtojca 1: Termat e Referencës / Përshkrimi i shërbimit</u>	7
<u>Shtojca 2: Deklarata nën betim nga operatorëve ekonomik</u>	7
<u>Shtojca 3: Formulari i propozimit teknik</u>	7
<u>Shtojca 4: Formulari i propozimit financiar</u>	7
<u>Shtojca 5: Udhëzime dhe informacione për Operatorët Ekonomik</u>	7

FTESË PËR KUOTIM TË ÇMIMIT

Të nderuar,

- I. Jeni të ftuar të paraqisni çmimin e kuotimit (*në e-mail adresën e dhënë në paragrafin 4*), për aktivitetin e prokurimit të cekur më poshtë në përputhje me udhëzimet e bashkangjitura për operatorët ekonomik.
- II. Kuotimi juaj duhet të pranohet deri në ora **23:59 më 28 gusht 2025** dhe do të mbetet i hapur në rast se data e fundit e lartpërmendur për dorëzimin e kuotimit të çmimit ndryshohet. Të gjitha dokumentet e paraqitura duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përshkruara në këtë ftesë të cilat përbëjnë Dosjen e Tenderit.
- III. Nga ju kërkohet të plotësoni dhe të ktheni **"Shtojcën 3: Formulari i propozimit teknik & Shtojcën 4: Formulari i kuotimit të çmimit"** së bashku me të gjitha shtojcat e kërkuara tek dokumentet e tjera në përputhje me ftesën për tender siç janë renditur në *Dokumentet që do të dorëzohen*.
- IV. **Titulli i kontratës:** Shërbime të përkthimit
Numri i referencës: FPK 01/2025
Data e shpalljes: 18 gusht 2025
Data e mbylljes: 28 gusht 2025
Kohëzgjatja e kontratës: 24 muaj
Autoriteti kontraktues: Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)
Adresa: Musa Tolaj, Lam A, H1, Kat.12, nr. 65-1, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Kosovë
Email Adresa për dorëzimin e ofertave: tender@kcsfoundation.org
- V. Për pyetje dhe informacione shtesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit dhe TeR ju lutem adresoni më poshtë:

E-mail: tender@kcsfoundation.org
Afati i fundit për pyetje: 25 gusht 2025, ora 10:00

Vetëm ofertuesit e suksesshëm do të kontaktohen për të caktuar kohën e përshtatshme për informacione shtesë nëse është e nevojshme.

Ju lutemi sigurohuni për të dorëzuar Ofertën në mënyrën dhe kohën e përshkruar në Udhëzimet dhe Informacionin për furnizuesit.

Me respekt,

Përshkrimi i Fushëveprimit

1	Hyrja & Përmbledhja	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) është organizatë e pavarur, jofitimprurëse, që vazhdimisht angazhohet në krijimin dhe zhvillimin e një shoqërie demokratike dhe pjesëmarrëse në Kosovë. Përgjatë më shumë se 25 viteve, KCSF ka kontribuar në promovimin e politikëbërjes së bazuar në dëshmi, zgjerimin e hapësirës qytetare dhe mbështetjen e mbi 750 nismave qytetare me një investim të konsiderueshëm prej mbi 30 milionë euro, ngritjen e njohurive dhe shkathtësive të mijëra aktivistëve/eve të shoqërisë civile në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor përmes më shumë se 1,100 sesioneve trajnuese.
2	Qëllimi i shërbimit	Me qëllim që të mundësohet komunikimi dhe informimi i drejtë dhe i saktë, pa u humbur kuptimi origjinal për individ, grupe ose organizata nga kultura dhe gjuhë të ndryshme, KCSF kërkon shërbime të përkthime tekstuale, simultante dhe konsektive, nga operatorë ekonomik që janë të regjistruar si kompani profesionale të përkthimit dhe zotërojnë kapacitete për ofrimin e shërbimeve të përkthime në gjuhë Shqipe, Angleze dhe Serbe. KCSF në këtë ftesë për koutim të çmimit kërkon nga kompanitë profesionale të përkthimit, ofertim për ofrimin e shërbimeve të përkthimit: LOT 1: - Përkthim dhe lekturim tekstual i materialeve nga gjuha shqipe në gjuhë angleze dhe anasjelltas; - Përkthim dhe lekturim tekstual i materialeve nga gjuha shqipe në gjuhë serbe dhe anasjelltas; - Përkthim dhe lekturim tekstual i materialeve nga gjuha angleze në gjuhë serbe dhe anasjelltas; - Lekturim tekstual i materialeve në gjuhën shqipe; - Lekturim tekstual i materialeve në gjuhën serbe; - Lekturim tekstual i materialeve në gjuhën angleze; LOT 2: - Përkthim simultan nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas; - Përkthim simultan nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas; - Përkthim simultan nga gjuha angleze në gjuhën serbe dhe anasjelltas; - Përkthim konsektiv nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas; - Përkthim konsektiv nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas; - Përkthim konsektiv nga gjuha angleze në gjuhën serbe dhe anasjelltas;
3	Përshkrimi i shkurtër i shërbimeve të kërkuara	
4	Qëllimi dhe fushëveprimi	Me qëllim të trajtimit profesional dhe brenda afateve të ngjeshura kohore, pavarësisht vëllimit të të gjitha kërkesave për përkthime, KCSF synon që për këto shërbime të kontraktojë së paku dy kompani profesionale të përkthimeve, pa të drejta ekskluzive për ndonjërin prej tyre. Kontraktimi

		planifikohet për periudhën kohore prej dy viteve, me mundësi vazhdimi.
5	Kushtet dhe kërkesat e dërgesës	Vendi i performimit të shërbimeve është: Kosovë
6	Kohëzgjatja e pritshme e shërbimit	Deri në 2 vite
7	Data e synuar për fillimin e shërbimit	15 shtator 2025
8	Data e vlerësuar për përfundimin e shërbimit	14 shtator 2027
9	Gjuha e propozimit	Shqip
10	A kërkohet udhëtime	☒ Kërkohet ☐ Nuk kërkohet
11	Emrat dhe biografitë e individëve që do të përfshihen në kryerjen e shërbimeve	☐ Kërkohet ☒ Nuk kërkohet
12	Valuta e Propozimit	EUR
13	Tatimi mbi vlerën e shtuar në propozimin e çmimit	☐ duhet të përfshijë TVSH-në dhe taksat e tjera indirekte të zbatueshme ☒ duhet të jetë pa TVSH dhe tatimet e tjera indirekte të zbatueshme
14	Periudha e vlefshmërisë së propozimeve (Nga dita e fundit e dorëzimit të ofertave)	☐ 60 ditë ☐ 90 ditë ☒ 120 ditë Në rrethana të jashtëzakonshme, KCSF mund t'i kërkojë Tenderuesve të zgjasin vlefshmërinë e Ofertës përtej asaj që është cekur fillimisht në këtë FPK. Ofertuesit pastaj do të konfirmojnë zgjatje e afatit me shkrim, pa ndonjë ndryshim në Propozim.
15	Ofertimi i pjesshëm	☐ Nuk lejohet ☒ Lejohet
16	Kushtet e pagesës	Pas ofrimit të shërbimeve, konform kërkesave dhe nevojave të KCSF, në baza mujore.
17	Lloji i kontratës që do të nënshkruhet	Kontratë për shërbime
18	KSCF do t'i japë kontratën:	☐ Një dhe vetëm një Ofruesi Shërbimesh ☒ Një ose më shumë Ofruesve të Shërbimeve, në varësi të faktorëve të mëposhtëm: ☒ Shtojca 1: Termat e referencës / Përshkrimi i shërbimit ☒ Shtojca 2: Deklarata nën betim nga tenderuesi ☒ Shtojca 3: Formulari i propozimit teknik ☒ Shtojca 4: Formulari i propozimit financiar ☒ Shtojca 5: Udhëzime dhe informacione për tenderuesin
19	Shtojcat e kësaj FPK-je	3 ditë pune para afatit të fundit për dorëzimin e ofertës
20	Afati i fundit për dorëzimin e pyetjeve për sqarim	☒ Shtojca 2: Deklarata nën betim nga tenderuesi ☒ Shtojca 3: Formulari i propozimit teknik ☒ Shtojca 4: Formulari i propozimit financiar ☒ Shtojca shtesë: Certifikata e regjistrimit dhe numrit fiskal dhe unik të biznesit nga organet përkatëse në vendin e origjinës që përcakton themelimin ose statusin ligjor, vendin e regjistrimit dhe vendin kryesor të operimit; ☒ Shtojca shtesë: Referencat për shërbimet e ofruara gjatë 3 viteve të fundit me theks në përvojë me organizata jo qeveritare ☒ CV-të e stafit të propozuar për detyrën, sipas kërkesave të kualifikimit në TeR
21	Dokumentet që do të dorëzohen:	

		☒ Certifikata e Cilësisë (p.sh., ISO, etj.) dhe/ose certifikata të tjera të ngjashme, akreditime, licenca për përkthime zyrtare, nëse ka të tilla.
22	Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	- Oferta më e favorshme (çmimi më i lirë në raport me cilësinë e kërkuar) - Deklarata nën betim nga personi juridik/fizik dhe parandalimi i konfliktit të interesit - Referencat - Kompania duhet të ketë së paku 3 vite përvojë të dëshmuar në fushën e shërbimeve të përkthimit - Krahës përvojës së dëshmuar, nevojitet personeli i kualifikuar, i cili zotëron njohuri dhe përvojë në fushën e përkthimeve. Preferohet ekip me eksperiencë pune prej jo më pak se tre vite në përkthim, që zotërojnë mirë programet bazë të kompjuterit, që kanë studiuar ose e njohin shumë mirë gjuhën të cilën e përkthejnë.

Vlerësimi i Ofertave - Kriteret e dhënies së kontratës për LOT 1

Ndërsa çmimi është faktor i rëndësishëm, KCSF do të vlerësojë propozimet në bazë të çmimit dhe kriterëve të mëposhtme:

KRITERI 1	Niveli i përputhshmërisë me FPK: i. Kuptimi i të gjitha pjesëve të FPK-së, ii. Cilësia e përgjithshme dhe niveli i profesionalizmit, iii. Propozimet/ofertat e dhëna janë në përputhje me udhëzimet,	Koeficienti	5 %
KRITERI 2	Dorëzimi i kërkesave dhe cilësia: i. Afatet kohore, ii. Përkthimi tekstual,	Koeficienti	20%
KRITERI 3	Përvoja dhe kualifikimet e ekipit: i. Përvoja e përgjithshme profesionale e kompanisë, ii. Përvoja relevante me organizata jo qeveritare, iii. Kualifikimet dhe shkathtësitë e ekipit kryesor, iv. Referencat,	Koeficienti	25%
KRITERI 4	Propozimi Financiar: i. Çmimi më i ulët (=Çmimi më i ulët/Çmimi i propozuar*40p), ii. Qartësia e çmimit dhe çmimi konkurrues 10p,	Koeficienti	50%

Vlerësimi i Ofertave - Kriteret e dhënies së kontratës për LOT 2

Ndërsa çmimi është faktor i rëndësishëm, KCSF do të vlerësojë propozimet në bazë të çmimit dhe kriterëve të mëposhtme:

KRITERI 1	Niveli i përputhshmërisë me FPK:		
	iv. Kuptimi i të gjitha pjesëve të FPK-së,		
	v. Cilësia e përgjithshme dhe niveli i profesionalizmit,	Koeficienti	10%
	vi. Propozimet/ofertat e dhëna janë në përputhje me udhëzimet,		
KRITERI 2	Përvoja dhe kualifikimet e ekipit:		
	i. Përvoja e përgjithshme profesionale e kompanisë,		
	ii. Përvoja relevante me organizata jo qeveritare,	Koeficienti	40%
	iii. Kualifikimet dhe shkathtësitë e ekipit kryesor,		
	iv. Referencat,		
KRITERI 3	Propozimi Financiar:		
	iii. Çmimi më i ulët (=Çmimi më i ulët/Çmimi i propozuar*40p),		
	iv. Qartësia e çmimit dhe çmimi konkurrues 10p,	Koeficienti	50%